

Prishtinë: 16/08/2006  
**ERO/CPD\_D\_05\_08\_06**

**Nga:** Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve

**Për:** Z. Mustafë Hajdari, adresa: Rr. Marigona, Fushë Kosovë, Kosovë

**Lënda:** Përgjigje në Kërkesën me Nr 10/7 2006 të datës 13.07.2006

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorit e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Përgjigjen e KEK-ut të datës 26.09.2005 në ankesën e konsumatorit nr.22 të datës 09.09.2005;
4. Ankesën e bërë nga konsumatori në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të regjistruar me 25.07.2006; me numer regjistrimi 10/7 2006;
5. Inicimin e procesit të ZAK (negocimit) nga DMK e ZRRE-së në mes të konsumatorit dhe divizionit të furnizimit të KEK-ut (26.07 – 09.08.2006), në pajtim me nenin 21.1 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve;
6. Njohtimin e konsumatorit për mospranimin e tij të ofertes së divizionit të furnizimit të KEK-ut për nënshkrimin e kontratës për riprogramimin të borgjit (dështim i procesit të negocimit); dhe
7. Në përputhshmëri me Nenin 14.3 të Rregullit mbi procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 16.08.2006 ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe bazuar në faktet e paraqitura dhe në bazë të kompetencave të dhëna sipas Nenit 14.3 të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve; Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve merr këtë:

### **VENDIM**

Kërkesa e Konsumatorit Z. Mustafë Hajdari nga Prishtina **ËSHTË REFUZUAR** për arsye të paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

### **Arsyetim**

Konsumatori në ankesën e tij të drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së të datës 25.07.2006 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut të datës 26.09.2005, e cila përgjigje i është dhënë konsumatorit me datën 25.07.2006 në lidhje me ankesën e tij nr 22 të datës 09.09.2005.

Konsumatori në kërkesën e tij kërkon lirimin nga pagesa e borgjit të ngarkuar në faturat e tij në vlerë prej 2,465.22 € për energjinë e konsumuar nga pronari i mëparshëm i njehësorit nr. 9189154 Mikic Cedomir, në periudhën prej 12/1999 deri më 07/2002..

Divizioni i furnizimit të KEK-ut kërkon nga konsumatori që të siguroi dëshmi nga gjyqi apo Habitati me të cilin dokument dëshmohet se borgji është obligim i shitësit të objektit banues në të cilën është rexhistruar njehsori nr 9189154 i ngarkuar me këtë borgj.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRRE-së, përgjigjen e KEK-u dhënë konsumatorit, dokumentat shtesë të ofruara nga konsumatori dhe duke u bazuar në Kornizen Ligjore të aplikueshme në Kosovë, konstaton se përgjigja e KEK-ut dhënë Konsumatorit ishte në pajtim me legjislacionin në fuqi, andaj refuzon ankesën e konsumatorit si të pabazë, për arsye se:

1. Konsumatori nuk ka Vendim të Gjyqit me të cilin borgji i ngarkohet pronarit të mëparshëm Mikic Cedimir.
2. KEK-u ka vepruar në bazë të kornizes ligjore në fuqi dhe në bazë të rregullave të lëshuara nga ZRRE.

**DEPARTAMENTI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE**  
**ERO/CPD\_D\_05\_08\_06, dt 16.08.2006**

**Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve**  
Azem Kastrati



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kunder këtij vendimi Konsumatori mund të ankohet në Bordin e ZRRE-së në afat prej katërmbdhjetë (14) ditëve kalendarikë nga dita e marrjes së të njejtit nga konsumatori apo nga dita e shpalljes ne faqen elektronike te ZRRE-së, cila do që ndodhë më parë.